



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.2/2024

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtares B.K, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga J.K, Përmbaues Privat pranë Organit Përmbaues “N. L.”, rruga “B.K.” nr..., në Pejë, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 05.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga J.K, Përmbaues Privat pranë Organit Përmbaues “N. L.”, rruga “B.K.” nr..., në Pejë, ndaj gjyqtares B.K, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 15.03.2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke vepruar konform nenit 9 par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë te autoritetit kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga J.K, Përmbaues Privat pranë Organit Përmbaues “N. L.”, rruga “B.K.” nr..., në Pejë, ndaj gjyqtares B.K, me arsyetimin se gjyqtarja nuk e ka shqyrtuar prapësimin e debitorit dhe lëndën e ka kthyer te përmbauesi dhe se sipas informatave jozyrtare, gjyqtarja i ka të njohur palët në procedurë me mbiemrin K. ashtu që e njëjta është dashur të tërhiqet zyrtarisht nga trajtimi i kësaj çështje e jo të luaj me organin e përmbaimit duke e endur lëndën me shkresa, andaj mbi bazën e të lartcekurave, me këto veprime konsideron se gjyqtarja ka cenuar interesin juridik të palëve duke prolonguar lëndën.

Me datë 19.03.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga J.K ndaj gjyqtares B.K.

Gjyqtarja B.K në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka deklaruar se sipas ankesës përmbauesi privat ka paqartësi dhe pakënaqësi sa i përket vendosjes në procedurën përmbaimore. Pretendimi i përmbauesit për afërsi familjare me palën debitor në këtë rast është i paqëndrueshëm dhe i pambështetur në asnjë provë, mbiemri i ngjashëm nuk do të thotë se krijon lidhje familjare me të gjithë personat që e mbajnë të njëjtin dhe se për të si gjyqtare nuk ka arsye të njohura që do t’a obligonin të kërkoj përjashtim nga kjo lëndë pasi që nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e përcaktuara me nenin 67 të LPK-së. E njëjta, ka theksuar se pretendimet e përmbauesit janë ngritur me të vetmin qëllim të vënies në dyshim të paanshmërisë së gjykatës, duke tentuar që t’i arsyetojnë paqartësitë që i ka si përmbaues lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e tij dhe se është e pakuptueshme se si përmbauesi ende nuk i ka të qarta se cilat janë kompetencat e tij në procedurë të përmbaimit, pasi gjykata lëndën në fjalë e ka kthyer te përmbauesi në mënyrë që ai të procedoj sipas obligimeve të tij ligjore të përcaktuara me nenin 110 par.1 të LPK-së. Sa i përket pretendimit për prolongim të procedurës dhe cenim të interesit juridik, gjyqtarja ka sqaruar se edhe pretendimi i tillë është i paqëndrueshëm, për shkak

se lëndën e ka pranuar në zyrë me datë 20.11.2023 dhe të njëjtën e ka proceduar me datë 02.02.2024, procedimi i lëndës është bërë në përputhje me ligjin dhe se për kthimin e lëndës te përmbaruesi janë dhënë arsye të mjaftueshme në aktet përcjellëse që i janë drejtuar përmbaruesit, ndërsa ankesën disiplinore e konsideron të mbështetur në pretendime të pasakta dhe absolutisht të pabazuara.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtares B.K, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore është e pabazuar.

Lidhur me pretendimin për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtares për shkak se e njëjta nuk e ka shqyrtuar prapësimin e debitorit dhe lëndën e ka kthyer të përmbaruesi, autoriteti kompetent gjen se veprimet e tilla nuk përmbajnë elemente të shkeljes disiplinore por, janë veprime procedurale të cilat i ndërmerr gjyqtari duke vepruar brenda autorizimeve dhe kompetencave të tij ligjore në drejtim të zgjidhjes së çështjes, e të cilat nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore andaj, në këtë procedurë autoriteti kompetent nuk do të lëshohet në elaborimin e këtij pretendimi.

Sa i përket pretendimeve se gjyqtarja ka afërsi familjare me debitorin dhe nuk ka kërkuar përjashtim nga trajtimi i çështjes, autoriteti kompetent gjen se pretendimet e tilla të paargumentuar dhe të pambështetur në asnjë provë por vetëm në “informata jozyrtare”, nuk janë bazë e mjaftueshme për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtares. Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, autoriteti kompetent në asnjë mënyrë dhe me asnjë provë nuk u bind se gjyqtarja B.K me veprimet e saj ka cenuar interesin juridik të palëve dhe e ka prolonguar lëndën ashtu siç pretendon parashtruesi i ankesës apo se e njëjta me veprimet e saj ka shkelur Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.2/24, me datë 05.04.2024

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtares B.K*
- 3. Parashtruesit të ankesës – J.K – përmbarues pranë Organit Përmbarues”N. L.”, rruga “B.K.” nr., në Pejë,*